

Ma. Alban DOBRUNA

TRAJTIMI I RELIGJIONIT NGA HOXHË KADRI PRISHTINËS NË REVISTËN “UDHA E S’ VERTETËS”

Kadri Prishtina i njohur më tepër si Hoxha Kadriu, bëri emër jo vetëm si atdhetar i devotshëm, por edhe si diplomat, jurist dhe publicist, që la mendime me vlerë edhe në fushën e publicistikës. Hoxha Kadri Prishtina ka qenë e do të mbetet një nga figurat e shquara kombëtare, shëmbëlltyrë frymëzimi për çështjen shqiptare. Kontributi i Hoxhë Kadri Prishtinës është shumë dimenzional, por ne po përqendrohemi në njërin nga segmentet e çmuara të veprimtarisë së tij si themelues dhe kryeredaktor i revistës “Udha e s’vertetës” dhe autor i shumë punimeve me vlerë kombëtare dhe fetare.

Në kohën kur Hoxhë Kadriu punonte në Shkodër si avokat, kishte menduar të nxirrte një revistë mujore, në të cilën të shprehte pikëpamjet e tij fetare¹.

Në bazë të analizës së përmbajtjes dhe fizionomisë së revistës kulturore-fetare “Udha e s’vertetës”, mund të nxjerrim disa të dhëna dhe rezultate, të cilat sadopak do t’i kontribuojnë historiografisë shqiptare me nivelin e lartë të kulturës dhe me frymën e fesë. Revista “Udha e s’vertetës” doli vetëm në tre numra, në tetor, nëntor e dhjetor të vitit 1923². Ne fakt, siç e shpreh Hoxhë Kadriu në parathënien e kësaj reviste e shfrytëzoi për të demaskuar disa të pavërteta, të cilat botoheshin në shtypin e asaj kohe që kishin për qëllim diskreditimin e fesë islame. Në numrin e parë të revistës ai i fton lexuesit të kontribuon me shkrime dhe premtan se faqet e “Udha e s’vertetës” do të jenë të hapura kurdoherë³. Ndër të tjera thekson se: “Atyne qi me shkrime të dobishme të veta kanë me na përkrahë në ket udhë, na qyshë tash i falemi nderës edhe u japim fjalë se faqet e “Udha e s’vertetës” pë ta kanë të hapura kurdoherë”⁴.

Evidente është që në të tre numrat, në varësi prej artikujve që i kemi në dispozicion, ka pasur më shumë përmbajtje nga tri fusha : politike, kulturore dhe fetare.

1 Qemajl Morina, *Hoxhë Kadri Prishtina mendimtar islam*, Dituria Islame, Prishtinë, f. 18; Shefki Osmani, *Panteoni iranian dhe iranologjet shqiptare*, Fondacioni Kulturor “Saadi Shirazi”, Tiranë, 1998, f.132.

2 Arkivi Qendror i Shqipërisë AQSH., “Udha e s’vertetës”, Shkodër, tetor, nëntor, dhjetor, 1923.

3 AQSH, “Udha e s’vertetës” Shkodër, tetor, Nr. 1, 1923. f. 4-5.

4 Po aty.

Në kryeartikullin e numrit të parë me nëntitull "Qëllimi e dëshira" Hoxhë Kadri Prishtina bënë përpjekje që tek popullata shqiptare të shmangen intrigat, ndasisë fetare e krahinore. Rrugën e vetme për tejkalimin e këtyre ndasive e sheh tek ngritja e nivelit të dijes në tërë popullatën, nëpërmjet përhapjes se njohurive nga lëmi e filozofisë, sociologjisë dhe i politikës.

Nga ky dialog ndërjetar, takimi, afrimi, bashkimi, bashpunimi dhe bashkëjetesa mes religjioneve të cilën ai e kërkonte, dëshmoi se ishte njeriu i ndjenjave të holla, që kishte shqetësime dhe përgjegjësi ndaj veprimeve të veta, që nuk i dukej kurrë e mjaftueshme për nevojat kombëtare. Hoxhë Kadri Prishtina thekson se: "E qe, pra na kemi për qellim kryesuer me i marrë para syshë të t'ana këto rrethana: Me këshillue bashkëfetarët t'onë, me u a mësue këtyne parimet e theshta të fesë, me i pështuë prej zhgatrimit të kryekputshëm, me i ngrehë zëmbat e tyre në vullndet të bashkimit e të jetuemit tok në shoqniën njerzore të sotshme, m'u munduem me i ba gjymtyrë të dobishëm për jetën shoqnore e kombtare t'onën gjith' ata gjymës-dijetarë t'onë, tue in folun këtyne mbi baza të shëndoshta e të verteta të besimit, me i dhanë një zhvillim mendtar krejt popullit, për deri sat ë na mrrijë fuqija, na lane të felozofis, të soçillogjis e të politikës"⁵.

Revista në fjalë si për ka përmbajtja që shtjellon, si për nga thellësia kohore që trajton dhe mbarështimi i mbështetur, jo vetëm që përbën një arritje të pakontestueshme të autorit por edhe një vlerë fetare, kulturore, letrare, shoqërore dhe politike.

"Udha e s'vertetës" konsiderohet edhe ndër revistat e para që i vuri themelet e jurisprudencës shqiptare⁶.

Fusha e interesimit dhe e trajtimit të çështjeve fetare, shoqërore dhe kulturore e Hoxhë Kadri Prishtinës ishte e gjerë dhe e rëndësishme. Ai ka lënë gjurmë të pashlyera dhe ka dhënë ndihmesë jashtëzakonisht të rëndësishme dhe shumë të dobishme edhe në trajtimin e çështjeve fetare te shqiptarët.

Maturia, kujdesi dhe mjeshtëria e shtruarjes dhe e trajtimit të çështjeve të fesë, sidomos me polemikat e tij, me intelektualët e kohës, është mase e dukshme dhe atë, duke filluar nga trajtimi i islamit si doktrinë për të vazhduar në mëshirimin e islamit te shqiptarët.

Hoxhë Kadriu potenconte vazhdimisht konstatimin se roli dhe rëndësia e fesë në historinë e shoqërisë njerëzore ka qenë shumë i madh dhe se duhet me kujdes të studiohet dhe trajtohet. Ai, theksonte se: "Historia, ç' do kom apo mbledhje shoqnore e njef influk të besimit; edhe na paraqet fakte se njerzija kumjiherë, në gjendje shoqnore, nik ka jetue pabesim d.m.th. të vertetë a pa të vertë, një mëndyrë a më një tjetër asht lutë edhe

⁵ Po aty.

⁶ Fjalor enciklopedik shqiptar. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë. 2009.f.2098: Marengel Verli. Nga Kosova për Kosovën profile biografike vëllimi i parë. Botimpex. Tiranë. 2006. f. 277.

ka zakonet e ceremonitë fetare te sajat. Animistat, feticistat, tutemistat, paganistat, e idhujtarët bile kanë ndjekë një mendim hyjnuar edhe i nu an shtrua e bindë njatyne rregullave të cillat kanë shkaktue nevojen e të lutunit”⁷.

I vetëdijshëm për nevojën dhe rendësin e trajtimit shkencor të religjionit, Hoxhë Kadriu, në mënyrë eksplicite, në të gjitha shkrimet e tij që ndërlidhen me trajtimin e religjionit i shtron konturat dhe kahjet, merr në konsideratë të kaluarën historike, shkaqet, rrënjët e besimeve të përhapura ndër të gjithë popujt. Ai pohon se: ”Do autorë qi janë marrë me hetimet e historis së besimeve e me studimet retrospektive, burimin e mendimit të besimit e kanë pshtetë në (frigë) e në (uzdajë) tue zhvillue kshtu: Njeri, për te paren herë qi pau rruzullimin, pat për ballë fenomene të ndryshme qi do ndër këta i lane në andje në shpirt e do i bane një përshtypje të mnuerëshme: rrenat e frikshme, stuhinnat e rrepta, termeqet rrenuse, rrjedhat permbytse t’ujnave njallen friga të thella në të mjerin njeri”⁸.

Në numrin dy të revistës “Udha e s’vertetës” duhet veçuar edhe një punim i Hoxhë Kadri Prishtinës, “Bisedim”. Në këtë punim si gjithherë, përpiqet t’i ulë tensionet fetare dhe t’u shmang provokimeve, që siç i quan ai i bëjnë miq tanë Jezuit. Ai shprehet se:” Miqt t’onë Jezuit në palljen e tyne donë të diftohen ma se të njerzidhëm e qi na myslimant i u dhimena; me folë të drejten çuditim pak kah nuk shohim një thjeshtsi n’at lajm therës e te pa-pritun. Pse, të luturat mund të bahen ndër kisha pa trazue kerkend e jo tue i hapër kisha pa trazue kerkend e jo tue i hapë me fletore; atëherë besojmë se lutjet do të kishin një sinçiritet e devocion ma të madh edhe nuk do të kapërceheshin kufirin e edukacionit (terbi)”⁹.

Në këtë numër dy, botohet një artikull me tematik të rëndësishme shoqërore dhe fetare me titull ”Profesioni më i keq”. Në këtë artikull Hoxhë Kadriu evidenton dy vese siç i quan ai të poshtra që dëmtojnë moralin dhe dobësojnë shpirtin e njerëzve: Spiunimin dhe thashethemet¹⁰.

Hoxhë Kadriu vënë theksin se këto sëmundje posaçërisht në politiken ballkanike, ambiciet e mëdha të politikanbërësve ballkanik u verbohen sytë me lufta partish. Këto sëmundje thekson Hoxhë Kadriu: “Janë përhapur së tepërmi, dhe një shumicë e njerëzve është detyrua me u bë spiun”¹¹.

Po ashtu i denoncon të gjitha veprimet tjera të liga që bëjnë disa njerëz që duke akuzuar, poshtëruar dhe grabitur nderin e tjetrit përfitojnë vetë.

7 AQSH, “Udha e së vërtetës”, Shkodër, nëntor, Nr.II, 1923, f. 34.

8 Vep e cit, f.35.

9 “Udha e së vërtetës”, Vep e cit, f.44.

10 Po aty.

11 Po aty.

Në po në këtë numër ai boton edhe artikullin “Kuvendi Kushtetues”, në të cilin shprehë mendimin, kundër mbajtjes së tij. Ai shprehet se: “Nuk po shesim profeci, por po flasim tuej shikjuë gjendjen dhe veprimen. Pra mendimi me thanë se; nuk kanë m’u realizuë dobiënata e të mirat e dishruëme qi janë në vijm në jeten publike e diën fort mirë se ni asamble qi do të formohet me principe partijaninash t’ekzaxheuëme, në vend të dobisë sillë dam. Nji shtet të cillit i vehen themelet mbas dishirit të nji partisë, nuk mund të qëndrojë; ligja themelore qi bahet prej nji kuvendit të tillë, nuk mund të plotsojë as dishiret e pakicës. Ma mire me thanë , në kjoftë se kjo ligjë nuk bahet mbas dishirit të gjith popullit, per nji kohë të shkurtë nje prej fuqisë ase e rrëzojnë e fillon anarkija”.¹²

Gjithashtu në interes është edhe një letër e hapur drejtuar Dr. Lor Rashës, që vijon edhe në numrin tre të kësaj reviste.

Dr. Lor Rasha në atë kohë mësimdhënës i historisë në Gjimnazin Shtetëror-Tiranë kishte dhanë disa shpjegime që nuk përkisnin me të vërtetës dhe që janë në kundërshtim me dogmat Islame¹³.

Punimi ka strukturë të qëlluar dhe lënda është e shtruar në pesë faqe . Punimit i paraprin hyrja, në të cilën autori fillimisht bënë fjalë për jetën dhe veprimtarin e profetit Muhamed. Këtu gjithashtu Hoxhë Kadriu bën një vështrim të thukët të rregullave dhe dispozitave të Islame.

Madhështia e Hoxhë Kadri Prishtinës qëndron edhe ne faktin që përveç trajtimit global që përpiket t’i bëjë problemit të historisë religjioze, ai orientohet edhe në aspekti e brendshëm ku spikat të metat e shqiptarëve në trajtimin e kësaj problematike.

Ai shprehet se qëllimi në reagimin e tij është të porosis: “Këta studjuësa kanë të drejtë me hapë sytë. Po qe se tjanjet (thënjët A.D.) qi diftojnë janë të verteta, s`mund të thohet gja. Prej kësaj perfiton mendimi njerzuer, por në kjoftë se ata thanje nuk perkojnë me të verteten e me të kendumit e së vertetësm, kish per të kenë si me ngulë kamë me ba me besue mendimin njerzuer mbi sende qi s`janë të verteta ma mire me thanë me e ba me besue thanje të rrejshme, e kjo asht e damshe për njerzi”¹⁴.

Hoxhë Kadriu ishte i përgatitur intelektualisht e shpirtërisht për të ndihmuar në ngritjen e nivelit më të lartë të vetëdijes kombëtare e njerëzore të bashkëkombësve të tij. Gjithashtu bëri përpjekje të pakursyera për të ndihmuar në jetësimin e aspiratave kombëtare dhe fetare.

Ai po tregonte se kishte ecur tutje, se ishte bërë pjesë e atij prototipi njerëzor që endet nëpër mote për të hapur shtigjeve të reja të jetës.

Në numrin tre boton përgjigjen e Dr. Lor Rashës me këtë shënim:

¹² Vëp e cit, f.55.

¹³ Po aty, f.55.

¹⁴ Po aty.

Në numrin e kaluar kemi pas dijet se kjo letër e hapur do të vijonte. Mik ynë z. Dr. Lor Rasha pa pritë mbarimin na ka çue një përgjigje. Meqenëse nderojmë tepër lirinë e mendimit po e botojmë ashtu si është.

Hoxhë Kadriu si çmues i mprehtë i zhvillimeve shoqërore, politike dhe fetare brenda dhe jashtë tokave shqiptare diktonte me saktësi kahet në raport me interesat e Kosovës dhe sugjeronte hapat për veprime të dobishme. Veprimtaria e tij fetare në këtë revistë vazhdon edhe në numrin tre, ku si kryeartikulli fillon me një Hytbe, që paraqet gjendjen shoqërore dhe politike duke me frazën: “O Shqiptar Mysliman! Memdheu po të thërret!”. Në këtë artikull, i fton të rinj aktivist të ngjarjeve politike të kohës, të mos vraponi pas interesave personal dhe lakmive materiale. Ai thotë: “Mos shifni as hatër as enteresë”¹⁵. Po në këtë punim Hoxhë Kadriu analizon rrethanat para dhe gjatë zgjedhjeve në atë kohë në Shqipëri. Hoxhë Kadriu bënte thirrje në mënyrë direkte ose indirekte në organizimin e ndershëm të këtyre zgjedhjeve, duke bërë thirrje që të fitoi më i ndershmi. Ndër të tjera thotë: “Biri im, këtë barren e Emanetit që t’a hodhi sot mil-leti në qafë t’ande mos e për-dorë per keq, por jepja ati qi asht i zoti, asht i ndershim, namuzqar e dinar. Mos ja ep atiqë të shet per nji zllotë, mos ja ep ati qës’ka frikë Zotin e s’beson as gja fare”¹⁶. Ai e përfundon këtë punim në mënyrën shumë të thjeshtë, duke u bërë thirrje siç i quan ai: “Bijtë e mi që të mos marrin mbi vete amanetin, që në të varen nevojat e atdheut dhe fesë. Ai i këshillon: “Se për ndryshe ke me e rrenue si vatanin ashtu edhe dinin”¹⁷.

Atdhetari i shquar Hafiz Ibrahim Dalliu për vlerën e madhe të kësaj reviste i shkruan Hoxha Kadri Prishtinës prej Tiranës: “I ndritshmi Hoxha, Doktor në Jurisprudencë .Jam gëzu kur kam këndue numrin e dytë të “Udhës së Vërtetë”. Ç”do fjale i mungon fuqia për ta cilësue atë . Rrnofshi. Travajët e zgjedhjeve më patën pengue të ju paraqes falënderimet me kohë. Tashti ato u kryen. Fitorja është e Xhokës. Kam mbledhe pajtimet që po shënoj më poshtë. Dëshiroj që të mos ma mungoni simpatinë tuaj imzot”¹⁸.

Revista në fjalë paraqet një aspekt të pandriçuar të aktivitetit dhe angazhimit të tij në historinë e jetës fetare të shqiptarët. Në këtë revistë vërehet përmbajtja e llojllojshme por edhe origjinaliteti i mendimit, duke përshtatur mendimet e tij me nivelin e masës dhe rrethanat e kohës. Për shkak të angazhimit të tij politik, Hoxhë Kadriu e ndërpreu botimin e revistës “Udha e s’ vertetës”. Gjatë kësaj kohe u vu në shënjestër të qarqeve të huaja antishqiptare. Për shkak të tyre u detyrua për një kohë, të mërgonte në Austri. Pas dy vjet vdiq dhe u varros në Shkodër më 1925.

15 AQSH, “Udha e së vërtetës”, Shkodër,tetor, Nr.III,1923, f. 65.

16 Po aty.

17 Po aty.

18 Pal Doçi, *Hoxha Kadri Prishtina*, Geer, Tiranë, 2005, f. 112.

Ma. Alban DOBRUNA

SUMMARY

**THE ASSESSMENT OF RELIGION BY HOXHE KADRI
PRISHTINA IN THE JOURNAL “UDHA E S’VERTETËS”**

Kadri Prishtina who was better known as Hoxha Kadriu became prominent not only as a devoted patriot, but also as jurist and publicist with valuable ideas in the field of publications. The contribution of Hoxha Kadri Prishtina has been multidimensional, and it is seen necessary to focus on a part of his abundant activities. He was the founder and editor in chief of the journal “Udha e s’vertetës” and author of many pieces of religious and national character.

At the time when Hoxha Kadri was working as a lawyer in Shkodra, he was planning to publish a monthly journal in which would express his religious views.

Based on the content analysis and the composition of his cultural religious journal, we derive some valuable data and results that could contribute to Albanian historiography with its cultural level and religious spirituality. The journal “Udha e s’vertetës”, came only in three numbers in 1923, October, November and December. Evidently in all three numbers, depending on the availability of articles, their content has been mainly focused in three areas: political, cultural and religious character.